



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2023:086310
Datë: 22.04.2024
Numri i dokumentit: 05604392

C.nr.1458/23

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtaren Rajmonda Kurteshi, në çështjen juridike - kontestimore të paditësit H.H. nga fshati B., Komuna Pejë, të cilin e përfaqëson Ardit Ibraj avokat në Pejë, sipas autorizimit, kundër të paditurit R.H. nga fshati B., Komuna Pejë, me bazë juridike vërtetim i të drejtës së pronësisë, vlera e kontestit 1000 euro, jashtë seance me datën 22.04.2024, mori dhe përpiloi këtë:

A K T V E N D I M

I. KONSTATOHET e tërhequr padia e paditësit H.H. nga fshati B., Komuna Pejë, e parashtruar me datë 07.04.2023, kundër të paditurit R.H. nga fshati B., Komuna Pejë, me bazë juridike vërtetim i të drejtës së pronësisë, vlera e kontestit 1000 euro.

II. Padia e tërhequr konsiderohet se nuk është paraqitur asnjëherë dhe mund të paraqitet në gjykatë përsëri.

Arsyetim

Në këtë gjykatë, paditësi H.H. nga fshati B., Komuna Pejë, përmes të autorizuarit të tij, ka parashtruar padi, kundër të paditurit R.H. nga fshati B., Komuna Pejë, me bazë juridike vërtetim i të drejtës së pronësisë, vlera e kontestit 1000 euro.

Gjykata, me datën 24.10.2023, ka pranuar parashtrësën e paditësit, me anë të së cilës parashtrësë, i njëjti ka deklaruar se e tërheqë padinë ndaj të paditurit për arsye objektive dhe subjektive.

Sipas nenit 261 par.1 dhe 2 të Ligjit Nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK), përcaktohet se: *“Paditësi mund ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi”* dhe *“Padia mund të tërhiqet edhe më vonë, deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor, në qoftë se I padituri e jep pëlqimin për një gjë të tillë. Po që se i padituri brenda shtatë (7) ditësh nga dita e njoftimit për tërheqjen e padisë nuk deklarohet për këtë gjë, do të konsiderohet se e ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e*

padisë”, andaj në referim të kësaj dispozite ligjore dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, rezulton se plotësohen të gjitha kushtet ligjore që padia në këtë çështje kontestimore, të konstatohet e tërhequr.

Gjykata në bazë të nenit 261 par.1, 2, 3, 4 dhe 5 lidhur me nenin 387 par.1, pika c) të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.1458/23, me datë 22.04.2024

Gjyqtarja,
Rajmonda Kurteshi

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankimi.